



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 41 datë 28.06.2024**

**“PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË V.K.B. NR. 55 DATË 29.12.2023 “ PËR  
MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR” I  
NDRYSHUAR.**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, me datë 28.06.2024, në mbështetje të nenit 27, nenit 54 gërma “dh” të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjit Nr. 97/2023 “ Për Buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 1 datë 24.01.2024, ligjit Nr 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, VKB-së Nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; shkresës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 3597/12 prot., datë 04.06.2024 “ Mbi çeljen e fondit për investimet e kërkuara nga Bashkia Shkodër”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr .307 datë 22.05.2024“ Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetqeverisjes vendore” dhe sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë dhe me propozim të Kryetarit të bashkisë Shkodër,

**VENDOSI**

1. Miratimin e shtesës së planit të Buxhetit të Bashkisë Shkodër për projektet kapitale të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit AMTP dhe Njesisë së Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile si më poshtë:

-Investimi me objekt: Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush; Kanali kryesor Mjedë ; KU-23 Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-23-1 Trush; Kanali kryesor Mjedë

KU-22-1; Bëltojë, Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush për zbatim të investimit në vlerën 75,560,770 lekë me TVSH në zërin Investime, prej të cilave shuma 32,400,000 lekë për vitin 2024 , shuma 43,160,770 lekë për vitin 2025.

-Investimi me objekt: Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç për zbatim të investimit në vlerën 51,853,884 lekë me TVSH në zërin Investime, prej të cilave shuma 15,000,000 lekë për vitin 2024, shuma 16,000,000 lekë për vitin 2025, shuma 20,853,884 lekë për vitin 2026.

-Investimi me objekt: “Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës” për zbatim të investimit në vlerën 12,162,007 lekë.

2. Miratimin e përdorimit të fondit rezervë të Bashkisë Shkodër, në programin 4910, artikulli 609, miratuar me V.K.B Nr. 55, datë 29.12.2023 “ Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, në vlerën 3,440,001 lekë, për mbulimin e kostove të mbikqyrjes dhe kolaudimit të projekteve të zbatimit, të financuara me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 226, datë 09.04.2024 “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 307 dt 22.05.2024 “ Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore” si më poshtë:

lekë				
Nr.	Nr. Programi	Aktiviteti/emertimi	Art. 231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	Institucioni likuidues
1		P4240 Q1 O1 A7- Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23-1 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22-1 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush <i>A1. Mbikqyrje</i>	1,706,436	Bashkia Shkodër

2	P4240 Q1 O1 A7- Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-23-1 Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22-1 Bëltojë, Trush Kanali kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush <i>A2- Kolaudim</i>	50,400	Bashkia Shkodër
3	P4240 Q1 O1 A8 - Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç <i>A1- Mbikqyrje</i>	1,300,855	Bashkia Shkodër
4	P4240 Q1 O1 A8 Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë-Kuç <i>A2 - Kolaudim</i>	48,000	Bashkia Shkodër
5	P3280 Q1 O1 A5 - “Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës” <i>A1- Mbikqyrje</i>	307,699	Bashkia Shkodër
6	P3280 Q1 O1 A5 - “Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje përroi i Bardhajve dhe Pistallës” <i>A2. Kolaudim</i>	26,611	Bashkia Shkodër
<b>TOTALI</b>		<b>3,440,001</b>	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të Nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Oltion LULI**



**Sekretare e Këshillit Bashkiak**

**Sabina DANAJ**

Miratuar me 33 vota

Vota Pro 33

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 02.07.2024